

K O D I
I DEONTOLOGJISË MJEKËSORE

I. RREGULLORJA HYRËSE

Neni 1

Me hyrjen në profesionin e mjekësisë, mjekët e Maqedonisë së Veriut në mënyrë solemne obligohen që:

- t'ia kushtojnë jetën humanizmit;
- ta kryejnë profesionin e tyre me ndërgjegje dhe përgjegjësi;
- ruajtja dhe kthimi i shëndetit i të mbrojturve, të jetë imperativi më i lartë në sjelljen e tyre;
- t'i ruajnë sekretet që u janë besuar në kryerjen e profesionit;
- të bëjnë të pamundurën për të ruajtur nderin dhe traditat fisnike të profesionit mjekësor dhe në kryerjen e detyrave të tyre mjekësore nuk do të lejojnë dallime për shkak të moshës, gjinisë, kombësisë, racës, përkatësisë politike, orientimit seksual, aftësive të vonuara dhe pozicionit social-ekonomik;
- do ta respektojnë jetën e njeriut që nga krijimi e më tutje edhe nën kërcënim, e nuk do të zbatojnë njohuritë e tyre mjekësore në kundërshtim me ligjet e njerëzimit; dhe
- do të tregojnë respektin e duhur ndaj mësuesve dhe kolegëve të tyre.

II. KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 2

Mjeku është i detyruar të kryejë shërbimet e duhura mjekësore, me ndjenjë dhe respekt për dinjitetin njerëzor.

Mjeku, së bashku me kolegët dhe bashkëpunëtorët e tjerë mjekësorë, është i detyruar t'i respektojë të drejtat e të sëmurëve dhe të ruajë besimin e tyre.

Mjeku është i detyruar t'i respektojë normat etike dhe deontologjike në profesionin e tij në marrëdhëniet mjek - mjek, mjek - pacient dhe mjek me punonjës të tjerë shëndetësorë.

Neni 3

Mjeku është i detyruar t'i respektojë ligjet dhe obligimet e tij, përveç rasteve kur ato janë në kundërshtim me interesin e shëndetit të pacientit.

Neni 4

Mjeku është i detyruar të angazhohet vazhdimisht dhe t'i thellojë njohuritë e tij profesionale dhe shkencore. Është i detyruar të kujdeset dhe të angazhohet për aftësinë profesionale, moralin dhe etikën e bashkëpunëtorëve; të paralajmërojë publikisht dhe hapur shkaqet e

sëmundjeve dhe të bashkëpunojë në mënyrë aktive në parandalimin dhe eliminimin e sëmundjes. Mjeku angazhohet për edukimin shëndetësor dhe për rritjen e ndërgjegjësimit shëndetësor dhe kulturës shëndetësore të njerëzve. Mjeku duhet të përpiqet të parandalojë gjithçka që rrezikon shëndetin e njeriut, të luftojë prapambetjen e përgjithshme dhe mjekësinë popullore.

Neni 5

Gjatë ushtrimit të profesionit, në kufijtë e fushave të përcaktuara të punës dhe aftësisë profesionale, mjekët janë të pavarur, përgjegjës dhe të ndërgjegjshëm, para pacientit, para organeve të Odës së Mjekëve të Maqedonisë së Veriut dhe para shoqërisë.

Neni 6

Mjeku është i detyruar, në pajtim me aftësinë e tij profesionale, të ofrojë ndihmë urgjente mjekësore dhe të kujdeset për trajtimin e mëtutjeshëm të personit të rrezikuar.

Neni 7

Theksimi i punës së tij dhe personalitetit individual nuk është në pajtim me profesionin mjekësor dhe Kodin e Deontologjisë Mjekësore (KODI).

Neni 8

Mjeku e dënon eutanazinë, duke u angazhuar të luftojë për jetën e pacientit deri në momentin e fundit.

Sipas parimit të respektimit të jetës së njeriut që nga ngjizja, në pajtim me parimet e humanizmit dhe shkencës mjekësore, mjeku e konsideron abortin si një akt biologjik, mjekësor-etik, psikologjik dhe të dëmshëm shoqëror. Mjeku e pranon abortin kur ka indikacione mjekësore, etike ose sociale për të.

Për parandalimin e abortit, ai e afirmon kontracepsionin, me mënyra dhe mjete moderne.

Neni 9

Ndër shkeljet më të rënda të parimeve etike është ekzaminimi i detyruar bio-mjekësor i njeriut. Procedurat e rrepta kontrolluese për testimin e metodave të reja shkencore të njeriut lejohen vetëm nëse janë të justifikuara mjekësisht dhe biologjikisht dhe nëse për këtë ekziston pajisje teknologjike dhe kuadrovike, sipas një rishikimi të mëparshëm nga një organ i lartë profesional dhe shkencor dhe pëlqimi të hulumtuesit ose kujdestarit të tij, përkatësisht përfaqësuesit.

Neni 10

Mjeku është i detyruar të bashkëpunojë në punët e përgjithshme - të dobishme që i shërbejnë mëkëmbjes së shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit njerëzor dhe të punës, duke u mbështetur në zbatimin e parimeve ekologjike.

III. PARIMET E VEÇANTA

1. Mjeku dhe shoqëria

Neni 11

Mjeku duhet të jetë i vetëdijshëm për rolin dhe rëndësinë e tij në komunitet. Prandaj, sjellja e tij dhe masat e marra janë gjithmonë në përputhje me udhëzimet që sigurojnë zhvillimin e mëtejshëm të shëndetësisë.

Neni 12

Mjekët kanë të drejtë dhe obligim, nëpërmjet organizatave të tyre profesionale dhe të tjera, të luftojnë për vlerësim adekuat të punës së tyre dhe të jenë të mbrojtur nga rreziqet profesionale.

2. Mjeku dhe veprimtaria shëndetësore

Neni 13

Mjeku vendos për çështje të ndjeshme që kanë të bëjnë me shëndetin dhe jetën e njeriut. Ai krijon detyrime. Kjo i krijon obligime, detyrime të veçanta dhe përgjegjësi personale që i jep kënaqësi profesionale dhe personale.

Neni 14

Mjekët përfshihen në procesin e pranimit, respektivisht në daljen e të sëmurit nga spitali, në procesin e trajtimit dhe rehabilitimin e të sëmurit, mbajnë llogari për karakteristikat e tyre personale dhe veçoritë e sëmundjes. Ndaj tyre duhet të kenë mirëkuptim dhe në rastet më të vështira të kenë ndikim qetësues.

Neni 15

Mjeku dhe organizata shëndetësore duhet të kujdesen dhe të sigurojnë vazhdimësinë e trajtimit, mundësisht me të njëjtin mjek, në pajtim me të drejtën e pacientit për të zgjedhur mjekun.

Neni 16

Mjeku nuk ka të drejtë të fillojë procedurë për të cilat nuk ka njohuri dhe përvojë adekuate. Përrjashtim bëjnë vetëm ndërhyrjet e nevojshme (urgjente) në lëndimet dhe sëmundjet që rrezikojnë drejtpërdrejt shëndetin dhe jetën e pacientit.

Neni 17

Mjeku nuk duhet të përdorë tituj që nuk i janë caktuar zyrtarisht. Nuk lejohet përdorimi i titujve të rremë që nuk përputhen me kualifikimet faktike, veçanërisht nëse kanë karakter reklamues.

Neni 18

Kujdesi shëndetësor nuk duhet të jetë një aktivitet i komercializuar. Mjekut i ndalohet çdo publicitet apo reklamë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë që nuk ka karakter edukativ apo mbrojtës.

Mjeku nuk guxon ta përdorë punën e tij në veprimtarinë e shëndetit publik për qëllime personale ose për të ofruar përfitime për persona të tjerë.

Mjekët refuzojnë çdo bashkëpunim me persona që ushtrojnë në mënyrë të paligjshme apo joprofesionale profesionin shëndetësor.

Mjeku nuk duhet të përfitojë shpërblime për promovimin e produkteve farmaceutike, kozmetike dhe të tjera.

Mjeku nuk duhet të pranojë ose të kërkojë shpërblime jashtë dispozitave të tarifave të përcaktuara.

3. Mjeku dhe pacienti

Neni 19

Mjeku është i detyruar të kryejë profesionin e tij me ndërgjegje, saktësi dhe përgjegjësi, pavarësisht nga mosha, gjinia, feja, kombësia, raca, përkatësia politike, orientimi seksual, hendikapi dhe statusi ekonomik-social dhe marrëdhëniet e tij personale me pacientin dhe familjen e tij.

Mjeku vazhdimisht mban llogari për arritjet e shkencës mjekësore dhe parimet e sjelljes profesionale dhe zgjedh lirisht metodën dhe mënyrën e trajtimit. Kur vendos për mënyrën e trajtimit, ai është i detyruar të mbështetet në rëndësinë dhe ndërgjegjen e tij, duke qenë i pavarur nga ndikimet e ndryshme apo dëshirat e papërshtatshme të pacientëve, të afërmeve të tij dhe të tjerëve.

Mjeku është i detyruar të refuzojë kryerjen e veprimtarive dhe ndërhyrjeve të cilat, sipas bindjes dhe ndërgjegjes së tij profesionale, mund të jenë jo etike ose të dëmshme për pacientin.

Neni 20

Pacienti me arsye pret që mjeku të jetë i kujdesshëm ndaj tij, ta kuptojë dhe të ketë durim me të. Efektiviteti i trajtimit varet shumë nga besimi i pacientit tek mjeku dhe metoda e trajtimit.

Veprimet e mjekut duhet të bazohen posaçërisht në masa që e lehtësojnë dhimbjen e pacientit dhe e rikthejnë shëndetin. Kjo marrëdhënie nuk duhet të kushtëzohet nga egoizmi, përmbushja e ambicieve personale apo synimi i mjekut për ndonjë përfitim personal. Mjeku nuk duhet të keqpërdorë ndikimin që ka tek pacienti.

Neni 21

Para se të fillojë mjekimi, mjeku është i detyruar të informojë pacientin për llojin e sëmundjes, gjendjen aktuale shëndetësore dhe parashikimet për rezultatin e sëmundjes. Ai, nga i sëmuri duhet të marrë pëlqimin e vetëdijshëm dhe vullnetar për mënyrat e parashikuara të trajtimit.

Informimi i pacientit për gjendjen e tij shëndetësore duhet të jetë i posaçëm dhe në kuptimin më të gjerë në favor të tij. Mjekun e detyron kujdesi dhe saktësia e veçantë në shpjegimin e aplikimit të metodave diagnostike dhe terapeutike lidhur me rrezikun. Kur i sëmuri është në gjendje të veçantë psikike, atij nuk i rekomandohen shpjegime nëse ato mund të ndikojnë negativisht në trajtimin e tij. Në raste të tilla është e nevojshme të informohen të afërmit e të sëmurit. Do të ishte e palejueshme që mjeku t'i shmangej asaj detyre të vështirë dhe pacienti ta merrte diagnozën nga personeli tjetër mjekësor. Nëse gjendja shëndetësore e pacientit nuk shfaq shpresë për shërim ose nëse i kërcënohet me vdekje, mjeku është i detyruar të njoftojë familjen e pacientit, përveç nëse vet ai vendosën ndryshe. Në asnjë rast i sëmuri nuk duhet të privohet nga kujdesi i mëtejshëm dhe duhet t'i jepet mbështetje morale.

Neni 22

Mjeku, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë pëlqim me shkrim nga pacienti pas çdo ndërhyrjeje, pasi e informon për ekzaminimet, diagnozën, metodat e trajtimit dhe prognozën. Vetëm në rast të ndërhyrjes urgjente, për shkak të rrezikut për jetën, nëse pacienti nuk është

në gjendje të jep pajtim, mjeku mund ta kryejë procedurën pa pajtimin e të sëmurit. Të miturit dhe personat nën kujdestari kanë kujdes dhe përgjegjësi të veçantë për mjekun. Në raste të tilla, gjatë përgatitjeve për intervenim, përkatësisht gjatë trajtimit të planifikuar, është e nevojshme që nga përfaqësuesit ligjorë të të sëmurit të merret pajtim i veçantë, përveç nëse ai është në rrezik konkret për jetën.

Neni 23

Mjeku është i detyruar që me pranimin në spital të informojë pacientët për procedurat rutine, për mënyrat e trajtimit dhe për mundësitë mjekësore-teknike që disponon institucioni shëndetësor.

Neni 24

Mjeku që e trajton pacientin, gjatë udhëzimit të të njëjtit në specialist, në spital ose në një këshill të mjekëve, duhet t'i sigurojë atij dokumentacionin e duhur mjekësor. E njëjta gjë vlen edhe për informacionin kthyes ndaj mjekut që shëron pacientin. Ekzaminimet e specializuara e ndihmojnë mjekun në trajtimin e mëtejshëm.

Neni 25

Mjeku nuk duhet të braktisë të sëmurin me një sëmundje të pashërueshme. Ai është i detyruar t'i ofrojë atij trajtim të vazhdueshëm, ndihmë dhe mbështetje morale.

Mjeku nuk ka të drejtë të largohet nga pacientët e tij në rast rreziku të përgjithshëm, me përjashtim të ndonjë urdhri të menjëhershëm, në pajtim me ligjin, të lëshuar nga organet kompetente të autoriteteve.

Neni 26

Mjeku angazhohet për mbrojtjen e fëmijëve të cilëve duhet t'u sigurohet trajtimi, edukimi dhe kujdesi i veçantë, veçanërisht nëse janë të paaftë fizikisht, mendërisht ose të pazhvilluar. Mjeku e trajton fëmijën në kuadër të familjes së tij (nënës).

Mjeku duhet të angazhohet për fëmijën e sëmurë, nëse formon një përshtypje se familja e fëmijës nuk e kupton sëmundjen ose nëse ata nuk bashkëpunojnë në trajtimin e tij.

Mjeku nuk do të pajtohet me lëshimin e një fëmije të mitur të sëmurë ose të sëmurit nën kujdestari kur, sipas tij, largimi nga spitali do ta rrezikonte rëndë shëndetin e pacientit ose të tjerëve. Lëshimi vendoset nga mjeku që e trajton pacientin.

Neni 27

Mjeku merr parasysh shqetësimet e familjarëve të sëmurit dhe do të bashkëpunojë me ta në pajtim me parimet etike të sëmurit.

Mjeku nuk duhet të ndërhyjë në marrëdhëniet familjare të pacientit.

Neni 28

Mjeku e merr parasysh dhe respekton parimin e zgjedhjes së lirë të mjekut dhe institucionit shëndetësor dhe përpiqet për realizimin e kësaj të drejte të pacientit/sëmurit.

Neni 29

Mjeku që e trajton pacientin, që jeton me familjen ose me një grup më të madh, përpiqet që të gjithë t'i respektojnë rregullat e higjienës dhe profilaksisë. Të sëmurin dhe të tjerët nga mjedisi i tij duhet t'i paralajmërojnë se ato janë përgjegjës për veten dhe të tjerët.

Neni 30

Nëse mjeku konstaton se pacienti sillet në mënyrë të papërshtatshme, e paralajmëron atë me kujdes, por me vendosmëri. Në rastin e fundit, mjeku mund të ndërpresë procesin e trajtimit, përveç nëse gjendja shëndetësore e pacientit kërkon kujdes urgjent mjekësor.

Nëse nuk ka rrezik specifik/konkret për jetën e pacientit ose nevojë tjetër për ndërhyrje të menjëhershme mjekësore, mjeku ka të drejtë të kërkojë përjashtimin nga trajtimi i mëtejshëm i pacientit në rast të:

- ekzistencës të një marrëdhënieje të ngushtë familjare ose emocionale;
- kërkesës së pacientit, familjes ose kujdestarit të tij, që janë në kundërshtim me parimet e etikës mjekësore dhe Kodit Penal;
- kontestit juridik me njëri-tjetrin;
- nëse konsideron se aftësitë e tij profesionale nuk janë të mjaftueshme për të ofruar ndihmën e nevojshme mjekësore.

Mjeku kërkon shkarkimin e tij me shkrim, nga udhëheqësi i institucionit shëndetësor.

Neni 31

Edukimi i personelit mjekësor dhe organizimi i veprimtarisë shëndetësore, të sëmurit në spitale dhe në shtëpitë e tyre duhet të u sigurojnë lehtësim efektiv të sëmundjeve të tyre, aq sa e lejojnë njohuritë dhe mundësitë moderne mjekësore.

Neni 32

Mjeku duhet të ndihmojë pacientin në plotësimin e të drejtave të tij shëndetësore dhe sociale, por nuk duhet të pajtohet me abuzime, mashtrime, certifikata false dhe dokumente të falsifikuara.

4. Mjeku dhe ndihma urgjente mjekësore

Neni 33

Mjeku nuk guxon të refuzojë kujdesin urgjent mjekësor, në përputhje me aftësinë e tij profesionale, pavarësisht nëse është në detyrë apo jo dhe pavarësisht nëse i është kërkuar në mënyrë eksplicite ndihmë. Në rast të epidemive, fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera masive, mjeku duhet t'u jep kujdes parësor më të rrezikuarve.

Neni 34

Rreziku për shëndetin apo jetën e tij nuk mund dhe nuk duhet të detyrojë mjekun që të mos e kryejë kujdesin urgjent mjekësor derisa ekziston rreziku për jetën e të sëmurit, përkatësisht derisa të sigurohet kujdesi dhe trajtimi i mëtejshëm, vetëm me përjashtim të rastit kur rrezikohet drejtpërdrejt jeta dhe shëndeti i mjekut.

5. Mjeku dhe kushte të jashtëzakonshme

Neni 35

Puna në kushte të jashtëzakonshme është veçanërisht e detyrueshme për mjekun. Ai duhet të njihet me parimet moderne doktrimore për punën në raste të jashtëzakonshme, në të cilat personeli shëndetësor ka një pozicion dhe përgjegjësi të veçantë.

Neni 36

Sipas parimeve të sigurisë dhe solidaritetit, mjekët, pavarësisht nga vendi i tyre i punës dhe aftësisë së tyre për punë, duhet të jenë të përgatitur për t'u paraqitur menjëherë në punë në raste të jashtëzakonshme, të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë morale dhe njerëzore.

Neni 37

Në rast lufte dhe konfliktesh të tjera të armatosura, mjeku është i detyruar ta respektojë Konventën e Gjenevës dhe protokollet shtesë.

6. Mjeku dhe edukimi shëndetësor

Neni 38

Kujdesi shëndetësor në praktikën dhe zhvillimin e përditshëm arrin rezultate solide dhe të qëndrueshme nëpërmjet edukimit shëndetësor të individit dhe popullatës.

Përkufizimi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë për shëndetin i detyron mjekët dhe punonjësit e tjerë shëndetësorë që të veprojnë në vendin e tyre të punës ose në jetën publike, në drejtim të edukimit shëndetësor dhe në këtë mënyrë të ndihmojnë njerëzit të arrijnë një cilësi më të mirë të jetës.

Neni 39

Mjeku përpiqet të drejtojë dhe trajtojë popullatën për ndihmë të parë dhe kujdes mjekësor në situata të jashtëzakonshme.

Mjeku merr pjesë në edukimin shëndetësor të Kryqit të Kuq dhe organizatave të tjera humanitare, të shërbimeve të shpëtimit dhe institucioneve të ndryshme arsimore.

7. Marrëdhëniet ndërmjet mjekëve dhe mjekëve me punonjësit shëndetësor

Neni 40

Bashkëpunimi i ndërsjellë mes mjekëve bazohet në miqësi, sinqeritet, çiltërsi, transferim dhe shkëmbim përvojash. Mjeku duhet t'i trajtojë kolegët dhe bashkëpunëtorët e tij ashtu siç dëshiron që ata ta trajtojnë atë.

Neni 41

Mjeku e vlerëson dhe respekton njohuritë, dinjitetin dhe profesionalizmin e çdo punonjësi shëndetësor dhe bashkëpunëtor tjetër, pavarësisht nga vendi i punës, sepse e di se vetëm marrëdhënie të tilla ofrojnë kushte për kreativitet dhe kritika konstruktive.

Neni 42

Marrëdhëniet e mjekëve të rinj ndaj kolegëve më të vjetër duhet të bazohen në respekt dhe korrektësi. Pastaj, ata janë të detyruar të kenë parasysh përvojat jetësore dhe profesionale të

të moshuarve dhe eprorëve, të cilët duhet të shërbejnë si shembull dhe drejtim për bashkëpunëtorët e rinj.

Neni 43

Rregullat e kolegjalitetit kërkojnë që mjekët të mbrojnë një koleg që është paragjykuar pa baza.

Neni 44

Solidariteti dhe respekti i ndërsjellë ndërmjet punonjësve shëndetësorë shprehet edhe me faktin se mjeku kujdeset kolegjisht për kolegun e sëmurë, për punonjësit shëndetësorë të sëmurë dhe për studentët e mjekësisë.

Neni 45

Dallimet në mendime asnjëherë nuk duhet të shkaktojnë moskorrektësi dhe të tejkalojnë rregullat e përgjithshme të sjelljes. Në raste kur mosmarrëveshjet nuk mund të tejkalohen, pajtimi është i domosdoshëm dhe urgjent përmes organeve të autorizuara të Odës së Mjekëve.

Neni 46

Në kontestet e punës dhe të tjera, mjeku është i detyruar të bëjë gjithçka që ato të zgjidhen sa më shpejt. Ai duhet të jetë i vetëdijshëm se marrëdhënie të tilla ndikojnë në moralin e punës dhe dëmtojnë reputacionin personal të mjekëve, reputacionin e profesionit mjekësor, organizatave shëndetësore dhe të sëmurëve.

Neni 47

Veprime të tilla si thashethemet, nënvlerësimi, kritika të pajustificuara ndaj kolegëve dhe bashkëpunëtorëve apo eprorëve në publikun laik, janë të padenjë për një mjek. Në rast të veprimeve më të rënda ose të përsëritura nga paragrafi paraprak, një sjellje e tillë do të bëhet akt i punës së Gjykatës së Nderit të Odës së Mjekëve.

Neni 48

Në rast të gabimeve të konstatuara objektivisht në procedurat diagnostike dhe terapeutike, mjeku është i obliguar që vërejtjet e tij t'ua përcjellë organeve profesionale të organizatës së tij punuese. Për papërshtatshmërinë profesionale të punës së një mjeku tjetër, mendimi jepet vetëm me shkrim pranë organeve përkatëse. Dhënia e një mendimi të tillë në prani të sëmurëve, personelit ndihmës apo publikut laik nuk lejohet dhe është i paqëndrueshëm profesionalisht. Mendimi negativ në një mjedis profesional lejohet vetëm në prani të mjekut të prekur. Vlerësimi duhet të jetë objektiv, i arsyetuar, pa lëndime apo fyerje personale.

Neni 49

Mjeku në grupin e punës ose njësinë e punës nuk jep vlerësim për trajtimin apo vlerësime të marrëdhënieve të ndërsjella të punonjësve shëndetësorë para pacientit. Nëse pacientët ankohen për trajtimin e punonjësve shëndetësor, ankesat duhet të shënohen për hapa të mëtejshme. Në bisedë të drejtpërdrejtë me të sëmurët, nuk duhet të bëhen deklaratat apo vlerësime për çështje të pastudiuara. Prezantimi i mënyrave të trajtimit është çështje profesionale dhe etike dhe e njëjta duhet t'u lihet organeve, organizatave apo institucioneve përkatëse profesionale.

Neni 50

Në zyrën e tij, mjeku mund të trajtojë çdo pacient. Nëse pacienti është trajtuar më parë nga një mjek tjetër, mjeku duhet të sigurohet që të njoftojë paraardhësin, nëpërmjet pacientit ose të afërmeve të tij. Nëse mjeku thirret menjëherë tek pacienti për të cilin kujdeset një mjek tjetër që nuk gjendet për momentin, pas dhënies së ndihmës mjekësore, ai duhet të informohet sa më shpejt dhe pacienti të dërgohet për trajtim të mëtejshëm. Mjeku i familjes ka të drejtë dhe detyrë të marrë pjesë aktive në trajtimin spitalor të pacientit të tij.

Neni 51

Mjeku nuk guxon, pa asnjë arsye, t'ia refuzojë ndihmën një mjeku tjetër, nëse ai kërkon ndihmë. Pacientët e dërguar nga një mjek tjetër, pas përfundimit të trajtimit, mjeku i kthen te mjeku që i ka dërguar, nëse nevojitet trajtim i mëtejshëm.

8. Mjeku dhe këshilli

Neni 52

Kur një mjek ka nevojë për ndihmë profesionale, konsultohet me një mjek tjetër ose këshill mjekësor. Këshillimi iniciohet nga një mjek që trajton pacientin, me dëshirë të pacientit ose të familjes së tij. Këshilltari mund të sugjerojë pacientin ose familjen e tij dhe për këtë vendos mjeku që e trajton pacientin. Në konsilium të gjithë mjekët kanë të drejta të barabarta.

Nëse dy profesionistë në këshill (konsilium) nuk mund të bien dakord, duhet thirrur një mjek i tretë.

Mjeku nuk mund të refuzojë pjesëmarrjen në këshill. Thirrja e mjekut në këshill duhet të konsiderohet si shprehje e besimit në njohuritë dhe aftësitë e tij.

Në rastet e vështira, të komplikuar, pavarësisht nga puna dhe aftësia profesionale, mjeku mund të vendosë në mënyrë të mendimit të këshillit.

Mendimi i këshillit mund të jepet edhe me shkrim nëse mjeku i këshillit ka marrë të dhëna adekuate.

Në parim, këshilli nuk diskuton dhe nuk merr vendim në prani të pacientit, respektivisht përfaqësuesit të tij,

Mendimi i këshillit duhet të shënohet në dokumentacionin shëndetësor, në organizatën shëndetësore ku trajtohet i sëmuri, së bashku me çdo mospërputhje eventuale në mendimin e anëtarëve individual të këshillit.

Neni 53

Pas kryerjes së kontrollit të sëmurit, mjeku që konsulton duhet të konsultohet me mjekun që e trajton pacientin. Rezultatit nga këshillimi i pacientit ose familjes së tij i kumton mjeku që e trajton pacientin.

Neni 54

Është moralisht jo korrekte të komentohet sëmundja dhe mënyra e trajtimit gjatë konsiliumit, në prani të pacientit dhe familjes së tij apo publikut laik.

Në këshill nuk ka vend për mos sinqeritet, prestigj, synime konkurruese dhe zili.

9. Mjeku dhe sekretet profesional

Neni 55

Mjeku është i detyruar me ligj të ruajë sekretin profesional. Sekret profesional është gjithçka që punonjësi shëndetësor dhe punonjësit e tjerë do të kuptojnë për pacientin dhe çështjet e tij personale ose familjare gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Sekreti profesional vlen për njoftimet me shkrim në lidhje me trajtimin e të sëmurit, për të gjitha analizat dhe incizimet. Mjeku është i detyruar të ruajë sekretin profesional nga familjari i të sëmurit, nëse kjo është në interesin e të sëmurit. Mbajtja e sekretit profesional është detyrë edhe pas vdekjes së të sëmurit.

Neni 56

Kur i sëmuri e liron mjekun nga mbajtja e sekretit profesional, mjeku vlerëson se çfarë njoftimi mund të dëmtojë të sëmurin dhe familjen e tij dhe cilat të dhëna do t'i mbajë sekret.

Neni 57

Mjeku dhe bashkëpunëtorët e tij janë të detyruar ta respektojnë sekretin profesional edhe në procesin arsimor. Këto parime duhet t'u barten edhe dëgjuesve të cilët obligohen t'u përmbahen atyre vazhdimisht.

Neni 58

Në botimet/publikimet kërkimore-shkencore gjatë mësimin, të dhënat për rezultatet dhe përfundimet e hulumtimit duhet të shpallen në mënyrë të tillë që të sigurohet anonimiteti i të sëmurit. Shfaqja publike e pacientit për qëllime shkencore ose edukative mund të bëhet vetëm me pajtimin e të sëmurit dhe në të njëjtën kohë duhet të sigurohet sekreti profesional dhe dinjiteti i tij personal.

10. Mjeku, përsosja profesionale dhe arsimimi

Neni 59

Ndjekja e vazhdueshme e arritjeve të mjekësisë dhe zhvillimit profesional është detyrë e çdo mjeku. Mjeku njohuritë e fituara profesionale duhet t'ua bartë kolegëve të tij dhe punonjësve të tjerë shëndetësorë. Zhvillimi dhe avancimi i vazhdueshëm i profesionit dhe shkencës mjekësore kërkon nga mjeku trajnim dhe edukim të vazhdueshëm në fushën e teorisë dhe praktikës mjekësore, përmes punës në shoqëritë e pavarura profesionale, shoqata, institucione shkencore dhe profesionale.

Neni 60

Mjeku është i detyruar të kujdeset vazhdimisht për rritjen e njohurive personale. Prandaj, tenton të pasurojë njohuritë e tij në fushën e shkencave njerëzore, shkencore dhe natyrore dhe fushën e përgjithshme shkencore.

Neni 61

Mjekët-punonjësit pedagogjikë janë të detyruar në çdo rast t'u kushtojnë vëmendje dëgjuesve për obligimet e veçanta që do të kenë në prezantimin e metodave të reja të mjekimit dhe në punën shkencore-hulumtuese si dhe në shpjegimin e njohurive dhe konstatimeve të reja, t'u kushtojnë vëmendje çështjeve moralo-etike të ndarë në ekzemplare të veçanta.

Mjeku është i detyruar të luftojë për kushte të tilla në shoqëri dhe në organizimin e kujdesit shëndetësor që do të mundësojnë përcjelljen e vazhdueshme të zhvillimit, të arritjeve dhe përsosjen e njohurive, aftësive në ofrimin e kujdesit urgjent mjekësor.

11. Karakteri profesional i mjekut

Neni 62

Mjeku në jetën profesionale dhe private kujdeset dhe i shfaq cilësitë personale, të përshtatshme në vendin dhe dinjitetin e profesionit të mjekësisë në shoqëri. Mjeku është i vetëdijshëm se për çdo veprim të pahijshëm, të pamatur, të pandershëm dhe poshtërues, komprometon të gjithë kolegët e tjerë.

Gjatë publikimit të botimeve profesionale dhe shkencore, mjeku është i detyruar të respektojë ligjet e përgjithshme për shtypin dhe paraqitjet publike.

Parimet etiko-morale në segmentin e publicistikës të profesionit mjekësor nuk janë në pajtueshmëri me plagjiaturën, me përgatitjen e rezultateve dhe të dhënave nga anketimet dhe hulumtimet, me falsifikimin e rezultateve, me zgjedhjen e të dhënave me përgatitjen e një modeli statistikor për fitimin e mjeteve financiare të projekteve shkencore ose profesionale, për bursa ose për përfitime të llojeve të tjera të fitimeve financiare.

Mosmarrëveshjet dhe diskutimet profesionale dhe shkencore mjeku mund t'i zhvillojë ekskluzivisht përmes revistave dhe konferencave shkencore dhe profesionale dhe jo përmes mediave të përgjithshme publike.

12. Aborti dhe sterilizimi

Neni 63

Mjeku i kushton vëmendje të veçantë procedurave për ndërprerjen e shtatzënisë, duke marrë parasysh aspektet biologjike, mjekësore, etike, psikologjike dhe sociale. Mjeku në përgjithësi e konsideron abortin të dëmshëm.

Neni 64

Mjeku nuk e pranon abortin si të vetmen mënyrë për të planifikuar një familje dhe për t'u përballur me kushtet e vështira sociale. Prandaj, mbi të gjitha, ai vazhdimisht përpiqet për popullarizimin dhe aplikimin e mjeteve kontraceptive moderne, të provuara e të miratuara shkencërisht.

Neni 65

Mjeku është i detyruar t'i respektojë dispozitat ligjore që rregullojnë ndërprerjen e shtatzënisë, duke mbrojtur zbatimin e vazhdueshëm të tyre.

Çdo ndërprerje e shtatzënisë, e cila nuk kryhet në përputhje me dispozitat ligjore, ai/ajo e konsideron si shkelje të rëndë deontologjike. Një mjek e konsideron ndërprerjen e shtatzënisë për përfitime materiale personale ose për përfitime të tjera si një shkelje veçanërisht të rëndë deontologjike.

Neni 66

Para fillimit të procedurës për ndërprerjen ligjore të shtatzënisë, mjeku është i obliguar që ta paralajmërojë gruan shtatzënë për mundësinë e pengesave serioze për shtatzënitë e ardhshme, veçanërisht nëse është shtatzënia e parë e gruas.

13. Trajtimi i vdekjes

Neni 67

Mjeku refuzon dhe dënon eutanazinë.

Neni 68

Në rast se një pacient është duke ndërruar jetë, mjeku duhet të bëjë gjithçka për të trajtuar dhe lehtësuar vuajtjet e tij. Vdekja e të sëmurit është pjesë e jetës.

Neni 69

Personi që vdes ka të drejtën e kujdesit, përkujdesjes dhe marrëdhënieve të veçanta njerëzore dhe pranisë së familjes në momentin e largimit, nëse ai që po ndërron jetë është i vetëdijshëm dhe e dëshiron atë.

Neni 70

Të sëmurit, që është duke ndërruar jetë e vdes në një institucion shëndetësor apo social, duhet t'i sigurohet kujdesi deri në momentin e vdekjes.

Neni 71

Në rast të vdekjes klinike, duke pasur parasysh rikthimin e saj, mjeku është i detyruar, në pajtim me njohuritë dhe aftësitë e tij teknike, të marrë të gjitha masat e mundshme për reanimim.

Neni 72

Mjeku do t'i shpjegojë me kujdes familjes së të sëmurit përpjekjet dhe procedurat e tij/saj për të lehtësuar vuajtjet e të sëmurit dhe deri ku mund të shkojë ndihma e tij.

Neni 73

Mjekët kanë detyrë njerëzore dhe morale që të sigurojnë që të gjithë pacientët të përgatiten psikologjikisht për vdekjen e pritshme dhe me gjithë ndihmën e duhur që do t'ia ofrojë personeli shëndetësor, i cili duhet të ketë arsimimin adekuat për të ndihmuar ata që janë duke ndërruar jetë.

Neni 74

Çdo hulumtim për qëllime pedagogjike, profesionale ose shkencore për një person që po ndërron jetë është i papajtueshëm me etikën mjekësore. Me përjashtim, hulumtime lejohen nëse i lehtësojnë vuajtjet fizike dhe mendore të një pacienti që po ndërron jetë e që nuk kanë elemente të eutanazisë.

14. Mjeku dhe hulumtimet bio-mjekësore dhe mënyra të reja trajtimi

Neni 75

Mjekut duhet t'i jepet mundësia të prezantojë dhe zbatojë metoda të reja diagnostikuese, terapeutike e parandaluese, por vetëm nëse ato janë testuar. Duke vepruar kështu, duhet të respektohet Deklarata e Helsinkit për Hulumtime Bio-mjekësore në njerëz.

Neni 76

Mënyrat e reja të trajtimit, mjeku i prezanton në pajtim me rregulloret dhe parimet ligjore për hulumtime bio-mjekësore.

Planifikimi i trajtimeve të reja mjekësore duhet të ofrojë një avantazh të përfitimeve të pritshme në marrëdhënie mbi rrezikun për shëndetin dhe jetën e njeriut – subjekt i hulumtimit.

Neni 77

Personi që dëshiron të aplikojë metoda të reja ose hulumtime mjekësore duhet të jetë i njohur me karakteristikat, sukseset e pritura, rrezikun e mundshëm dhe rreziqet e mundshme në procedurë. Por, gjatë kësaj kërkohet pëlqimi vullnetar, jo i detyruar për të aplikuar metodën e re ose për të tentuar një lloj të ri trajtimi. Me kërkesë të pacientit ose me vlerësimin e studiuesit, hulumtimi duhet të ndërpritet.

Neni 78

Nëse metoda e re e trajtimit mjekësor ose e mjekimit është një mundësi e përhershme dhe e vetme për të shpëtuar jetën e pacientit, dhe ai nuk është në gjendje të vendosë me vetëdije, pajtimin mund ta japë përfaqësuesi ligjor i pacientit. Në raste të tilla duhet të shkruhet paraprakisht një kërkesë e kujdesshme profesionale për domosdoshmërinë e aplikimit të metodës së re të trajtimit. Kërkesa nënshkruhet nga anëtarët dhe drejtuesit e ekipit mjekësor që e ka trajtuar pacientin.

Në asnjë rast nuk lejohet përdorimi i metodave të reja me qëllim të përdorimit të metodave të reja dhe me qëllim të ardhjes deri tek të dhëna shkencore për fëmijët me vonesë mendore, të burgosurit dhe personat në pozitë të varur ndaj zbatuesit për ekzaminim.

Procedurat e reja diagnostikuese dhe ndërhyrjet terapeutike që mund të shkaktojnë ulje të rezistencës fizike dhe mendore të pacientit, lejohen vetëm në rastet e masave urgjente gjatë trajtimit, vetëm në interes të shërimit ose të uljes së vuajtjeve të sëmurit.

Neni 79

Embrioni ose fetusit duhet trajtuar si një qenie njerëzore e mundshme, e gjallë apo sikur të jetë e gjallë, prandaj duhet t'i jepet respekti i duhur. Një embrion ose fetus i gjallë nuk duhet të përdoret si objekt eksperimentesh në mitër. Lejohen vetëm ndërhyrje të natyrës terapeutike, për të përshpejtuar rritjen, për të trajtuar ose për të lindur një fëmijë. Deontologjikisht, nuk lejohet mirëmbajtja artificiale e embrionit ose fetusit, me qëllim të kryerjes së hulumtimit ose marrjes së indeve për qëllime shëndetësore.

Neni 80

Ndalohet përdorimi i embrionit ose fetusit njerëzor për qëllime tregtare/komerciale ose industriale. Marrja e indeve nga një embrion ose fetus i vdekur nuk mund të kushtëzohet me kompensim monetar.

Neni 81

Indikacionet deontologjike dhe mjekësore për ndërprerjen e shtatzënisë dhe kushtet në të cilat do të kryhet ndërprerja nuk duhet të ndikohen nga dëshira për të përdorur embrionin ose fetusin për ndonjë qëllim.

Neni 82

Përparësi për transplantimin e indeve kanë pacientë, natyra e sëmundjes së të cilëve dikton urgjencë për një ndërhyrje të tillë. Mjeku është i detyruar ta konstatojë me ekzaminime përkatëse dhe ta vërtetojë atë.

Neni 83

Marrja e transplanteve nga dhuruesit e gjallë është e mundur vetëm kur dhuruesi njihet në detaje me rreziqet që mund t'i shkaktohen, përkatësisht me komplikimet dhe pasojat e mundshme që më vonë mund të shfaqen në shëndetin e tij ose t'ia rrezikojnë jetën e tij. Në vendime të tilla mjeku do të kujdeset për një dokument me shkrim, i cili konsiderohet sekret profesional.

Heqja e organeve nga personat e gjallë, me qëllim të transplantimit të të sëmurit është e mundur vetëm me pajtim me shkrim nga dhuruesi, i cili duhet të informohet. Nuk lejohet heqja e organeve nga të miturit, atyre me vonesë mendore ose personave me përgjegjshmëri të zvogëluar.

Neni 84

Mjeku nuk merret me heqjen e organeve dhe indeve apo me transplantim, nëse nuk është i trajnuar posaçërisht për këtë ose nuk ka ekip të kualifikuar, gjegjësisht pajisje teknike – mjekësore. Nuk lejohet as mjeku të përfitojë nga pacienti, familja e tij apo publiku gjatë transplantimit të organeve.

15. Mjeku dhe publiku

Neni 85

Theksimi i punës dhe i personalitetit të vet nuk është në pajtim me profesionin e mjekësisë. Përpara një publiku laik, mjeku nuk do të publikojë rezultatet e ekzaminimeve, metodave dhe mjeteve të trajtimit që nuk janë mjaftë të testuara.

Neni 86

Të gjitha botimet profesionale në mediat popullore duhet të synohen vetëm për popullarizimin e profesionit dhe shkencës mjekësore dhe për përhapjen e edukimit të përgjithshëm shëndetësor dhe kulturës shëndetësore.

Publikimi jo kritik i metodave diagnostikuese dhe metodave që nuk janë mjaftueshëm të testuara për mjekim për një publik jo profesionist dhe fshehja e rreziqeve të metodave të tilla është një shkelje deontologjike.

Deklaratat e mjekëve për barnat, dietën apo mjetet e tjera sanitare duhet të jenë gjithmonë në nivel profesional, në radhë të parë në shtypin shëndetësor dhe shkencor, dhe në media në një nivel që do të kontribuojë në edukimin shëndetësor të popullatës. Nuk lejohet që mjeku të publikojë apo shpallë pa argument mënyrat e suksesshme por të paprovuara të mjekimit dhe barnat e patestuara. Është e papranueshme që një mjek, në marrëveshje me pacientin ose familjet e tyre, të lejojë që të bëhet një njohje publike.

Neni 87

Propagandimi për sanatoriume, institute, klinika, industri të ndryshme farmaceutike, kozmetike apo punonjësit shëndetësorë të caktuar, nuk është në pajtim me profesionin e mjekut. Njoftime të tilla profesionale mund të publikohen vetëm në media rreptësisht profesionale ose media të specializuara.

Në mediat publike njoftimet janë të mundshme vetëm kur bëhet fjalë për një konfirmim të bazuar në përgjithësi të metodave të reja të punës, pra formave të reja të trajtimit, pasi ato metoda tashmë janë bërë pjesë e njohurive shëndetësore. Prandaj, mjeku asnjëherë nuk i informon paraprakisht metodat e reja të mjekimit që i hulumton, përkatësisht me të cilat merret.

Nuk lejohet për shkaqe morale dhe etike që mjeku të vë profesionin dhe kontaktet e tij profesionale në funksion të afirmimit qytetar dhe veprimtarive të tjera.

16. Mjeku – punonjës publik

Neni 88

Duke qenë se objekti i punës së mjekut është shëndeti dhe jeta e njeriut, puna e mjekut nuk mund të trajtohet si zanat, por si profesion. Përkatësia në atë profesion zgjat nga diplomimi deri në vdekje, dhe kjo nënkupton detyrime të veçanta të vendosura nga standardet morale-etike dhe rregulloret ligjore.

Neni 89

Sjellja dhe veprimet e mjekëve duhet të jenë në pajtim me ndërgjegjen dhe standardet moralo-etike të tyre

Neni 90

Mjekët në çdo mënyrë dhe me përgjegjësi përpiqen të zhvillojnë shëndetin në përputhje me situatën socio-ekonomike. Prandaj janë të detyruar, që sa më tepër të kontribuojnë në atë zhvillim.

17. Mjeku dhe mjekimi i detyruar

Neni 91

Mjeku që ushtron profesionin e tij në institucionet ku i sëmuri është i internuar me forcën e ligjit (spitale psikiatrike, të burgosur etj.), duhet të respektojë gjithmonë interesin e të sëmurit, personalitetin e tij të plotë dhe udhëzimet e Kodit të Deontologjisë. Mjeku, sipas mundësive të tij, duhet të parandalojë ose raportojë çdo veprim që mund të dëmtojë personin, gjendjen fizike dhe psikike të sëmurit.

Neni 92

Mjeku në asnjë rrethanë nuk duhet të lejohet të merr pjesë në torturim ose forma të tjera poshtërimi dhe mosrespektimi ose ta mundojë veten, pavarësisht nga krimi i kryer, në akuzën ose bindjen e viktimës, veçanërisht në rast lufte ose konflikte civile.

Neni 93

Tortura është përmbledhje e vuajtjeve psikofizike, të shkaktuara qëllimisht dhe sistematikisht nga një ose më shumë persona, me iniciativën e tyre ose me urdhër vetanak, me qëllim të imponohen deklarata, mirënjohje ose bashkëpunim të viktimës.

Neni 94

Mjeku nuk duhet të ofrojë hapësirë, material apo njohuritë e veta që do ta mundësojnë torturën.

Neni 95

Kur mjeku konsideron se gjatë një grevë urie, një i burgosur ose një person tjetër është i vetëdijshëm për pasojat e urisë, ai nuk guxon të propozojë ushqim artificial dhe as të bashkëpunojë në të njëjtën.

Mendimi i mjekut se i burgosuri ose personi tjetër është në dijeni të pasojave të urisë duhet të konfirmohet dhe nga një mjek tjetër. Të dy mjekët duhet t'i sqarojnë të burgosurit ose të tjerëve pasojat e urisë në shëndetin e tyre.

Nga momenti kur i burgosuri ose personat e tjerë gjenden në një gjendje në të cilën nuk mund të kuptojnë rëndësinë e veprimeve të tyre ose t'i menaxhojnë ato, mjeku është i detyruar t'u japë atyre ndihmë mjekësore.

Neni 96

Mjeku –psikiatër kurrë nuk duhet të marrë pjesë në trajtimin e detyruar psikiatrik, kur nuk bëhet fjalë për sëmundje mendore.

18. Mjek – ekspert

Neni 97

Mjeku ekspert duhet të kryejë punën e tij të ekspertizës në pajtim me ndërgjegjen dhe njohuritë e tij dhe të japë mendimin dhe gjetjet e tij në mënyrë të saktë dhe të plotë, duke respektuar parimet etike të profesionit të mjekësisë. Pavarësisht nga qëndrimi personal apo qëndrimi tjetër ndaj të prekurve, eksperti në hulumtim duhet të jetë i paanshëm, i sinqertë dhe profesional.

Neni 98

Eksperti në punën e tij është i detyruar të respektojë sekretin profesional.

Gjatë punës së ekspertizës, në raport me pacientin e tij, ai do të bëjë gjithçka që të lirohet nga ekspertiza. Në pajtim me autoritetet gjyqësore, ai paraqet vetëm të dhëna dhe konstatime që janë të rëndësishme dhe të nevojshme për procedurën.

Neni 99

Eksperti duhet të veprojë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, pavarësisht nga interesi i klientit, gjegjësisht palës së prekur. Gjetja dhe mendimi i ekspertit duhet të jenë të ndara.

Neni 100

Puna e ekspertit duhet të jetë shumë profesionale dhe morale, në nivel të lartë. Në asnjë rast ai nuk duhet të jetë ofendues dhe arrogant kur njohuritë dhe mendimet i tij eksperte nuk janë në pajtim me mendimin e një eksperti tjetër.

Neni 101

Kur eksperti jep konstatimin apo mendimin e tij, duhet të jetë i mbështetur profesionalisht dhe bindës, teksa konstatimi duhet të bazohet posaçërisht në argumente. Eksperti nuk duhet të përfshihet në argumente personale. Konstatimet e tij në rrethana të drejtpërdrejta, nuk duhet të jenë personale apo subjektive.

Neni 102

Në gjykatë, eksperti duhet t'u përmbahet pyetjeve të bëra. Ai u përgjigjet qartë, në detaje dhe me themel dhe mbi të gjitha në mënyrë të kuptueshme. Nëse konstaton se njohuritë e tij nuk janë të mjaftueshme, gjegjësisht se duhet një studim më i gjerë dhe plotësues i çështjes, detyrohet t'i kushtojë vëmendje gjykatës dhe të sugjerojë se në cilat çështje duhet të zgjerohet ekspertiza ose cilët ekspertë duhet të thirren.

Neni 103

Mjekut ekspert për punën e tij i takon një çmim të veçantë.

19. Mjek – mbikëqyrës

Neni 104

Mjekët - mbikëqyrës janë persona të autorizuar, të përcaktuar me ligj.

Mjekët – mbikëqyrës njoftojnë paraprakisht mjekët tek të cilët do të kryejnë mbikëqyrjen.

Neni 105

Mjeku mbikëqyrës duhet të respektojë sekretin mjekësor dhe mund të zbulojë vetëm konkluzionet të natyrës administrative. Ai e informon Odën për çdo konstatim që nuk është në pajtim me këtë Kod.

Neni 106

Në punën e tij, mjeku mbikëqyrës duhet të jetë objektiv dhe nuk duhet të ndërhyjë drejtpërdrejt në punën e mjekut që trajton të sëmurët. Për mosmarrëveshje në lidhje me mjekimin nga ana e mjekut, mjeku – ekspert fillimisht do të informojë mjekun dhe udhëheqësin e tij profesional, ndërsa për devijime më të rënda Odën e Mjekëve të Maqedonisë së Veriut.

20. Mjeku dhe e drejta ndërkombëtare humanitare dhe dispozitat deontologjike

Neni 107

Parimet humanitare ndërkombëtare janë të detyrueshme për mjekët në punën e tyre profesionale në parandalim, kurim dhe rehabilitim.

Neni 108

Oda e Mjekëve të Maqedonisë së Veriut duhet të informojë vazhdimisht mjekët dhe publikun për dokumentet e miratuara nga OKB-ja (OBSh, UNICEF, FAO dhe organizatave të tjera ndërkombëtare shëndetësore, sociale dhe humanitare).

Neni 109

Oda e Mjekëve të Maqedonisë së Veriut, përmes përfaqësuesve të saj, rregullisht e informon opinionin ndërkombëtar për përpjekjet e vendit tonë në përhapjen e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe humanitare dhe deontologjisë mjekësore.

Neni 110

Fakulteti i Mjekësisë, institucionet e tjera arsimore, organizatat e punës shëndetësore, organizatat e punonjësve shëndetësorë dhe shoqatat e tyre profesionale, janë të detyruara në ligjërata, në mediat e tyre, në kongrese dhe tubime të tjera profesionale, t'i kushtojnë vëmendjen e duhur përhapjes së parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe humanitare dhe parimeve mjekësore deontologjike.

Neni 111

Oda e Mjekëve të Maqedonisë së Veriut kujdeset për respektimin, zhvillimin dhe promovimin e përhershëm ose të përkohshëm të Kodit të Deontologjisë Mjekësore.

Neni 112

Kodi i Deontologjisë Mjekësore i Odës së Mjekëve të Maqedonisë së Veriut, udhëzimet e Shoqatës Botërore të Mjekëve dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë janë të detyrueshme për të gjithë mjekët në Maqedoninë e Veriut. Prandaj, ata janë të detyruar t'i njohin parimet dhe t'i zbatojnë ato në kryerjen e punës së përditshme dhe të përgjegjësive të përgjithshme njerëzore. Nga këtu rrjedh e drejta dhe detyra e organizatave profesionale të mjekëve, pavarësisht nga anëtarësia e Odës së Mjekëve të Maqedonisë së Veriut, të marrin masa ndaj mjekëve që i shkelin ato parime. Fakulteti i Mjekësisë dhe shkollat e tjera për punonjësit shëndetësorë janë të detyruar t'i marrin masat e duhura ndaj dëgjuesve dhe mësuesve që shkelin dispozitat e këtij Kodi.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 113

Kodi i Deontologjisë Mjekësore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e miratimit.